



Nr. 6 Prot.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
K R Y E S I A

Tiranë, më 08.01.2018

URDHËR

Nr. 1 Datë 08.01.2018

“Për ngritjen dhe përbërjen e Jurisë së çmimeve shkencore kombëtare vjetore për vitin 2017”

Drejtuar: Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike
Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike
Të gjithë akademikëve
Sektorit të Bibliotekës dhe të botimeve Shkencore në ASH
Sektorit të Financës

Mbështetur ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë” neni 4, pika dh, si dhe të Urdhërit Nr. 11, datë 6 tetor 2016 “Rregullore për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të Konkurseve, për kriteret e zgjedhjes së fituese dhe mënyrën e shpalljes së tyre”, neni 13; në “Thirrje për pjesëmarrje”, në edicionin e dytë të çmimeve shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë,

KONSTATOJ:

Nevojën për të zbardhur përbërjen nominale të emrave të Jurisë së çmimeve shkencore kombëtare vjetore për vitin 2017. Për këtë, pas kryerjes së procedurës zyrtare për përcaktimin e emrave nga institucionet pjesëmarrëse në Juri;

URDHËROJ:

Ngritjen e Jurisë së çmimeve shkencore kombëtare vjetore për vitin 2017 me këtë përbërje:

Kryetar : **Akademik Muzafer Korkuti**, përfaqësues i Kryesisë së ASH-së.
Anëtar : **Akademik i Asociuar Gjovalin Shkurtaç**, përfaqësues i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike.

- Anëtar : **Akademik Edi Pinguli**, përfaqësues i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike.
- Anëtar : **Akademie e Asociuar Aurela Anastasi**, përfaqësuese e SSHSHA të Asamblesë së ASHSH.
- Anëtar : **Akademik Floran Vila**, përfaqësues i SSHNT të Asamblesë së ASHSH.
- Anëtar : **Akademik Dhimitër Haxhimihali**, përfaqësues i akademikëve mbi 75 vjeç.
- Anëtar : **Geron Kamberi**, përfaqësues i Agjencisë së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit pranë Ministrisë së Arsimit.
- Anëtar : **Ermal Elezi**, përfaqësues i Ministrisë së Arsimit.
- Anëtar : **Prof. Dr. Adrian Civici**, përfaqësues prej rrjetit të universiteteve private shqiptare “UET”, gjegjësisht nga shkencat shoqërore.
- Anëtar : **Prof. Dr. Andrea MALIQARI** përfaqësues prej rrjetit të universiteteve shqiptare me titullin “Profesor”; gjegjësisht nga shkencat teknike-natyrore.
- Anëtar : **Z. Sokol Gjoka**, përfaqësues i Komisionit Kombëtar të UNESCO-s pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.
- Anëtar : **Prof. Enver Hysa**, përfaqësues i Komisionit Kombëtar të AIESEE.
- Anëtar : **Andi Rrëmbeci**, përfaqësues i Akademisë së të Rinjve pranë ASH-së.

2. Juria do të përcaktojë fituesit e çmimeve shkencore vjetore kombëtare si më poshtë:

- Çmimin *Eqrem Çabej*, për veprat më cilësore origjinale monografike në shkencat shoqërore dhe albanologjike (1-një fitues);
- Çmimin Petrit *Radovicka*, për veprat, projektet apo patentat e regjistruara më të rëndësishme në shkencat natyrore dhe teknike (1-një fitues);
- Çmimin *e karrierës akademike*, për merita jetësore në të dyja fushat e përmendura, që do të jepet duke iu referuar vlerësimit retrospektiv të rezultateve në kërkimin akademik-universitar, me rëndësi për shkencën shqiptare dhe jetën e vendit (1-një fitues);
- Çmimin për *studiuesin e ri më të suksesshëm*, që do të përzgjidhet prej brezit më të ri të kërkuesve qysh në fillimet e punës së tyre shkencore (2-dy fitues, nga një për secilin seksion).

3. Secili prej çmimeve ka vlerë financiare e cila përcaktohet në urdhërin për shpalljen e fituesve.

4. Fituesit e çmimeve pajisen me Diplomë dhe me emblemën e çmimeve.

5. Juria shpall jo më vonë se dyjavëshi i parë i Janarit 2018 listën e plotë të konkurrentëve dhe jo më vonë se dy javësh i parë i shkurtit 2018 listën me të nominuarit për secilin prej çmimeve, jo më shumë se katër prej tyre për çdo çmim. Ngarkohet Kryetari i Jurisë për organizimin e mbledhjeve në respektim të afateve të mësipërme.

6. Anëtarët e jurisë nuk mund të konkurrojnë për çmimet kombëtare shkencore.

7. Sekretare shkencore e jurisë është dr. Albana Velianj, përgjegjëse e sektorit të botimeve dhe bibliotekës shkencore e cila përgjigjet për organizimin e mbledhjeve dhe administrimin e materialeve të Jurisë.

8 Juria ka sekretarinë teknike e përbërë nga asistentet e seksioneve shkencore të ASH-së Vitore Veli dhe Anita Berberi. Sekretaria mban procesverbalet e mbledhjeve dhe mbështet teknikisht të gjitha procedurat që kryhen prej Jurisë deri në përfundim të dhënies së çmimeve.

9. Vlerësimi i kandidaturave bazohet në standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe në parametrat bazë të *ekscelencës*.
10. Juria ka të drejtën e një shpërblimin përfundim të punës së saj në masën e 35.000 lek për secilin anëtar. Ngarkohet sektori i financës për nënshkrimin e kontratave individuale dhe përmbushjen e këtij detyrimi.
11. Ngarkohen seksionet shkencore për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhëri.
12. Ngarkohet sekretaria e Jurisë për administrimin dhe shpërndarjen e këtij urdhëri.
13. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI SHKENCOR

